

MEHMET ÇELIKU

KONCEPTE DHE TERMA TË RINJ TË SINTAKSËS SHQIPE

Kumtesa e pranishme është vazhdim i dy trajtesave tona të mëparshme e pikërisht i kumtesës me titull *Për një teori të re sintaksore të gjuhës shqipe*, mbajtur në Konferencën shkencore “Gjuha shqipe në 100 vjet shtet shqiptar”, organizuar nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë të UT më 13.11.2012, dhe i kumtesës *Çështje të terminologjisë gjuhësore (fusha e sintaksës)*, mbajtur në Konferencën shkencore ndërkombëtare me temë “Terminologjia në shkencat e ligjërimit”, organizuar nga Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Prishtinës në Elbasan më 13.3.2012 (botuar së pari në librin tonë “Çështje të Shqipes Standarde”, Tiranë, 2014, f. 408-412). Këto dy kumtesa trajtojnë, e para, disa koncepte të reja nga fusha e sintaksës, tjetra, termat e rinj gjegjës (korrespondues).

*

* * *

Sintaksologët më të shquar shqiptarë të pasluftës janë: K. Cipo, M. Domi, S. Floqi. Veprat, tekstet, monografitë, studimet dhe artikujt e këtyre autorëve shënojnë një thellim dhe një rritje cilësore në gjuhësinë shqiptare në përgjithësi dhe në fushë të sintaksës në veçanti. Këta gjuhëtarë mbështeten në teoritë sintaksore europiane të kohës kur kanë jetuar, kryesisht, në gjuhësitë e vendeve ku kanë studiuar, përkatësisht në gjuhësinë italiane, franceze, ruse. Studimet e tyre i takojnë sintaksës përshkruese tradicionale me disa elemente të gjuhësisë strukturaliste. Ndër të tjera, do të përmendim këtu disa koncepte sintaksore strukturaliste të S. Floqit, siç janë *teoria e togfjalëshit*, teori e futur dhe e përpunuar në sintaksën shqipe prej tij dhe që u pranua përgjithësisht nga gjuhëtarët e tjerë shqiptarë, duke u aplikuar prej tyre rreth dyzet vjet; në të vërtetë, kjo teori s’është gjë tjetër veçse reflektim në gjuhën shqipe i teorisë strukturaliste europiane perëndimore të përbërësve sintaksorë (të përbërësve të fjalisë, sintagmave); në gjuhësinë strukturaliste mbështeten edhe konceptet e Floqit për *gërshetimin e aspektit semantik me atë strukturor* si në studimin e fjalisë së thjeshtë ashtu edhe të periudhës; risi tjetër shënon edhe metoda e studimit të llojeve të ndryshme të periudhave me nënrenditje, ku periudha shihet si një tërësi e njësuar dhe sifjalitë e saj shihen të lidhura midis tyre. Bashkëkohore janë konceptet, sidomos të Floqit, për formësimin e periudhës, për mjetet gramatikore e leksikore të formësimin, si për sistemin lidhëzor, për fjalët lidhëse, për vështrimin e foljes-kallëzues si komponent bazë i fjalisë dhe

zgjërimit e saj, koncepti për gjymtyrëzimin aktual, për rolin e kontekstit, të situatës, të intonacionit, të rendit të fjalëve dhe të sifjalive në periudhë, për bashkëlidhjet mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues etj. Duke u mbështetur mbi kriteret e tilla, nëpërmjet analizave e përshkrimeve shkencore të hollësishme, S. Floqi arrin në klasifikime e kategorizime të suksesshme, disa prej të cilave i kanë qëndruar kohës. Pa monografitë e thelluara të Floqit për tipat e ndryshme të periudhave, vështirë se mund të realizohej Gramatika e Akademisë (1996) në cilësinë që gëzon. Në arritjet e Floqit u mbështetën disa studime sintaksore të mëvonshme. Si shembull po përmend vetëm studimin për *periudhën me sifjali të varur përcaktore* (ku autori dallon i pari disa nëntipa semantike-strukturore të saj), mbi të cilin mbështeten studiues të tjerë të mëvonshëm për të arritur në klasifikime të reja në përputhje edhe me sintaksën bashkëkohore, siç janë: M. Totoni (2012), F. Koleci (2013), Th. Dhima (2013), M. Çeliku (2012).

S. Floqi ishte një gjuhëtar i kompletuar; ai i plotësonte në mënyrë ideale tri kërkesat themelore që i duhen një studiuesi në fushë të gjuhës: njohje e thelluar e gjuhës shqipe, nivel i lartë teorik, punë me pasion gjer në orët e vona të natës. Për S. Floqin, me të cilin kam pasur fatin dhe nderin të punoj në një sektor dhe në një zyrë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dua të shtoj edhe diçka: ishte njohës shumë i mirë i rusishtes dhe i frëngjishtes, por ai lexonte edhe në disa gjuhë të tjera, si në anglisht, italisht, rumanisht, serbokroatisht; plotësonte vazhdimisht dijet e tij me literaturë të re të huaj, duke porositur sistematikisht botimet më të reja ruse, të vetmet që atëherë ishin të mundshme. S. Floqi shquhej si nuhatës e zbulues i rrallë i ngjyrimeve më të imta semantike e stilistike të strukturave sintaksore. Me punën e tij intensive në fushën e sintaksës na la një numër të konsiderueshëm monografish, referatesh, artikujsh, kapitujsh të Gramatikës së Akademisë, të cilat presin të botohen në disa libra. Gjithashtu S. Floqi ka punuar edhe në fushë të dialektologjisë dhe ka lektuar si pedagog i jashtëm në UT. Por, për fat të keq, me gjithë këto arritje të shënuara, S. Floqi sa ishte gjallë nuk mori vlerësimet zyrtare dhe gradat shkencore që i takonin. Është detyra jonë dhe e shoqërisë së sotme t'i plotësojë këto mangësi.

*

* *

Sintaksologët kryesorë shqiptarë të para e të pas Luftës, gjatë shkollimit të tyre jashtë vendit, kanë rënë në kontakt me teoritë sintaksore europiane, teori këto që në një ndërkohë rreth tetëdhjetëvjeçare përjetonin ndryshime e zhvillime të theksuara: kontakte të tilla kanë pasur edhe sintaksologët e paraluftës (Xhuvani, Sheperi, Rrota) edhe ata të pasluftës (Cipoja, Domi, Floqi).

Vitet e fundit (pas 1990) u krijuan mundësitë që gjuhësia shqiptare të njihet më mirë me gjuhësinë bashkëkohore perëndimore europiane-amerikane. Krahas njohjes, gjuhëtarët shqiptarë u përpoqën edhe t'i aplikojnë teoritë sintaksore strukturaliste e gjenerativiste në studimin e shqipes. Aktualisht të aplikuarit e tyre ka ndodhur në të gjitha disiplinat gjuhësore, përfshirë sintaksën; madje në fushë të sintaksës përpjekjet për zëvendësimin e sintaksës tradicionale me sintaksën strukturaliste e gjenerative kanë përparuar kënaqshëm. Por njohja, zotërimi e sidomos aplikimi i teorive të reja janë procese të vështira që kërkojnë kohë. Në fushë të sintaksës ky proces ka ndodhur shkallë-shkallë. Elemente të para të teorive të reja sintaksore gjejmë që në sintaksën përshkruese tradicionale të shqipes (Sheperi, Rrota, Cipo, Prifti), më vonë te Sintaksa e Akademisë, në punët e Floqit, të Domit etj. Disa gjuhëtarë të tjerë shqiptarë e kosovarë, si: R. Memushaj, Th. Dhima, L. Rugova, T. Kelmendi, R. Përnaska, M. Totoni, F. Koleci, G. Turano, L. Buxheli, T. Topalli, Th. Rushi etj. e kanë intensifikuar shikimin e tyre kah gjuhësia bashkëkohore strukturaliste dhe gjenerative, duke shënuar arritjet e para në zbatimin e këtyre teorive të reja në shqipe; ndonjë gjuhëtar ka sjellë në shqipe një informacion të gjerë për gjuhësinë moderne europiane-amerikane, sidomos për gjenerativizmin (Memushaj), ndonjë ka kërkuar të operohet në analizën sintaksore shqipe me teorinë e sintagmës (Rugova), ndonjë gjuhëtar tjetër në tekste universitare e parauniversitare të shqipes ka interpretuar tema të caktuara me koncepte të sintaksës strukturaliste e gjenerativiste (Dhima, Koleci-Turano, Beci); pastaj prurjet janë shtuar e thelluar: ka vazhduar puna e frytshme informative, përshtatëse e krijuese e gjenerativistit shqiptar Memushaj si dhe janë hartuar monografitë e disertacionet e para për tema të veçanta të sintaksës së shqipes, vështruar sipas këndvështrimeve të reja të sintaksës moderne (J. Mita, L. Buxheli, F. Koleci, L. Lumezi etj.); gjithashtu u përkthyen edhe disa vepra themelore të gjuhëtarëve të njohur strukturalistë (R. Ismajli, R. Memushaj etj.). Siç shihet, kalohet gradualisht nga punët me karakter kryesisht informues e përshtatjet e para të teorive të reja gjuhësore, nga kërkesa për përfshirjen në shqipe të koncepteve të veçanta sintaksore e nga aplikimi i pjesshëm i tyre në studimin e shqipes e deri në vështrime më të thella monografike. Të gjitha këto përbëjnë përpjekjet e para të suksesshme për të arritur pastaj në një sintaksë moderne të shqipes. Vështrimet e para ishin me shumë interes, megjithëse kufizoheshin në çështje të veçanta, shoqëruar herë-herë me paqartësi e pasaktësi, në ndonjë rast ishin zbatim shabllon i ndonjë teorie. Ndonjë nga këta gjuhëtarë nuk e kishte plotësisht të qartë, madje, as konceptin për sintagmën në raport me fjalën e sifjalinë duke përjashtuar mundësinë e shprehjes së saj me një fjalë të vetme emërtuese në fjalinë e thjeshtë a me një sifjali në periudhë etj.

Më 2012 u botua *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, në të cilën synohet zëvendësimi i sintaksës tradicionale shqipe me një sintaksë të re bashkëkohore moderne e të plotë. Kjo Sintaksë i vendos përbërësit sintaksorë (sintagmat) dhe lidhjet e tyre të drejtpërdrejta në qendër të analizës sintaksore të fjalisë së thjeshtë dhe të periudhës. Ndërtimet sintaksore të shqipes aty vështrohen në sistem në dritën e koncepteve teorike të gjuhësive bashkëkohore strukturaliste europiane-amerikane, sidomos në ato teori që i përshtaten më shumë shqipes, duke pasur në konsideratë specifikat e kësaj gjuhe; si rrjedhim, vështrimi përmban edhe një dozë origjinaliteti.

Siç dihet, konceptet e reja teorike shprehen me termat përkatës. Në këtë Sintaksë për të shprehur konceptet e reja teorike kemi përdorur rreth 80 terma sintaksorë, të cilët në shumicën e rasteve janë terma të rinj a me kuptim të ri. Disa janë shqipërime nga anglishtja: *caktuesor* (për *specifikues, modifikues*); *plotësor* (për *komplement*); *shtesor* (për *axhant*); disa janë krijuar a përshtatur prej nesh: *sifjali* (për *clause*); **përbërës sintaksor** (**përbërës i fjalisë**, shkurt **përbërës**) (për *sintagmë, frazë a grup fjalësh*); **përbërës i thjeshtë**; **përbërës i thjeshtë i zgjeruar**; **përbërës i zbërthyeshem** (për *sintagmë a frazë komplekse*); **kryepërbërës**; **fjali dykryepërbërëse**; **fjali njëkryepërbërëse**; **fjali pa përbërës**; **përbërës sifjali**; **përbërës homogjenë**; **përbërës i veçuar**; **pasqyrë e pluseve**; disa terma janë përdorur edhe para nesh nga gjuhëtarë të tjerë me të njëjtin kuptim: **valencë**, **argument**, **parametra**, **parime**, **tekst**, **modifikoj**, **modifikues**, **specifikues**, ose janë përdorur me kuptim tjetër (**përbërës**, **plotësor**, **caktuesor**).

Në literaturën sintaksore vendase sot qarkullojnë edhe shumë terma të tjerë, kryesisht me prejardhje nga gjuhësia gjenerative, që nuk bëjnë pjesë në grupin e termave gjuhësorë shumë të njohur, por gjithsesi kanë interes dhe përdoren në analiza sintaksore të caktuara, duke ruajtur në shumë raste një trajtë a strukturë të huazuar nga gjuhë të huaja, si: **parime** a **parime universale** (të **përbashkëta**); **parametra**; **strukturë e thellë**; **strukturë sipërfaqësore**; **rol tematik**; **argument**; **kokë relative**; **intensifikator**; **kuantifikator**; **sintagmë kuantifikatore**; **komplement**; **komplementues**; **sintagmë komplementuese**; **determinant**; **sintagmë determinante**; **sintagmë fleksionale** (për **përbërës eptues**) etj.; ka edhe terma të tjerë të rinj nga fusha e gramatikës (morfologji e sintaksë), si: **klasë fjalësh**, **kategori fjalësh**, **kategori leksikore**, **kategori joleksikore**, **kategori funksionale**, **valencë e foljeve**, **valencë e emrave**, **folje njëvalente**, **dyvalente**, **trivalente**, **zerovalente**, **emra jovalentë**, **emra valentë**, **emra argumentorë**, **emra joargumentorë** etj.

Mbi përdorimin aktual të termave sintaksorë në studimet sintaksore dhe në tekstet universitare shqiptare. Siç u tha, konceptet e reja teorike kërkojnë termat e tyre gjegjës (korrespondues) të rinj, prandaj, përditësimi teorik, shoqërohet edhe me përditësimin, plotësimin terminologjik.

Njohja e përdorimi i termave të rinj shkon paralel me njohjen e përvetësimit të koncepteve të reja teorike gjegjëse, ku parësore sigurisht janë vetë konceptet teorike. Gjetja e termave të përshtatshëm është një punë shumë e vështirë, sidomos në raste të tilla kur bëhet fjalë për shifra të larta të tyre. Por mjaft kohë kërkon edhe zotërimi e përdorimi i tyre.

Në punime dhe tekste universitare, krahas termave tradicionalë të njësuar prej kohësh e të mbijetuar (ata kanë mbijetuar sepse përgjithësisht kanë mbijetuar edhe konceptet teorike që shprehin), si: *gjymtyrë* (fjalie), *kryeffjalë*, *kallëzues* (*kallëzues foljor*, *kallëzues emëror*, *kallëzues foljor i thjeshtë*, *kallëzues foljor i përbërë*), *kundrinor* (*kundrinor i drejtë*, *kundrinor i zhdrejtë*, *kundrinor me parafjalë*), *kallëzuesor*, *rrethanor*, *përcaktor*, *ndajshim* etj., qarkullojnë edhe shumë terma të rinj në përputhje me zhvillimet teorike të fundit në fushë të sintaksës. Aktualisht në disa universitete shqiptare po bëhen përpjekjet e para për zotërimin e këtyre termave të rinj. Për këtë luajnë rol kryesisht tekste bazë që përdorin studentët në lëndën e sintaksës. Por në shkollat e larta dhe në studimet tona sintaksore në fushë të terminologjisë mbizotëron sot subjektivizmi dhe një paqëndrueshmëri e theksuar, ndër të tjera, rrjedhë e faktit se konceptet teorike akoma nuk janë përafuar sa duhet. Gjendja kaotike e terminologjisë sintaksore në studime dhe në tekste universitare mund të ilustron me dhjetëra shembuj: Madje edhe për emërtimin e dy njësive sintaksore, për **fjalinë** dhe për **sintagmën**, përdoren disa terma: siç e kam theksuar edhe në një rast tjetër, për termin e parë (**fjali**) luhatjet terminologjike janë rrjedhim i konceptimit të ndryshëm teorik, sepse disa gjuhëtarë vazhdojnë ta konceptojnë atë sipas sintaksës tradicionale (duke e njohur periudhën si njësi të veçantë sintaksore dhe jo si variant të fjalisë dhe termin fjali e përdorin edhe për fjalitë e thjeshta edhe për pjesët e periudhës). Kështu, për të emërtuar fjalinë e variantet e saj përdoren këta terma: *fjali*, *fjali e mëvetësishme*, *fjali e pavarur*, *fjali kryesore*, *fjali e varur*, *fjali e nënrenditur*, *fjali e thjeshtë*; *periudhë*, *fjali e përbërë*, *frazë* (termin *frazë* e përdorin Totoni, Dhima, Koleci; kjo e fundit përdor termin *frazë* zakonisht për periudhë, por e përdor edhe për fjali të thjeshtë; në 'Frazat...' 2013 f. 142; po aty gjithashtu përdor edhe termin *fjali e thjeshtë*, f. 34, 144, 139; Totoni në 'Sintaksa...' 2012, përdor *frazë e thjeshtë*, f. 7, por edhe *fjali e thjeshtë*, f. 280, si dhe *frazë e përbërë*, f. 7, si: *frazë* lejore, f. 243, *frazë* sasiore, f. 153, *frazë* përjashtimore, f. 269 etj.; Dhima përdor termin *frazë* për fjali të thjeshtë, për periudhë dhe për sifjali (Dhima, Gjuha shqipe, Gjirokastër, 2010, f. 9, 11, 22; për emërtimin e pjesëve të periudhës nga gjuhëtarë të ndryshëm përdoren termat: *fjali*, *pjesë*, *frazë*, *njësi*, *sifjali* etj. Për emërtimin e njësisë tjetër sintaksore, të sintagmës, përdoren gjithashtu disa terma: *sintagmë* (Dhima, Koleci), *frazë*, *grup fjalësh* (Dhima), *përbërës sintaksor* (Çeliku).

Të pastabilizuar janë edhe shumë terma të tjerë nga fusha e sintaksës, si: *specifikues, modifikues, plotës, caktuesor, plotësor, shtesor, përbërës i zbërthyeshëm, përbërës i thjeshtë, sintagmë e thjeshtë, kryepërbërës, përbërës kokë, zgjerues, shoqërues, shoqërues i detyrueshëm, shoqërues jo i detyrueshëm (shtesor fakultativ), përcaktor, rrethanor* (Dhima përdor termin rrethanor vetëm për elementet fakultative të fjalisë, f. 19), *rrethanor plotësor, rrethanor shtesor, fjali dykryegjymtyrëshe, fjali dykryepërbërëse, fjali njëkryegjymtyrëshe, fjali njëkryepërbërëse, fjali e thjeshtë pa përbërës, fjali e plotë, fjali e paplotë, sifjali kryesore, sifjali e varur, frazë e nënrenditur, pjesë e nënrenditur, sifjali plotësore, sifjali shtesore, sifjali përcaktore plotësore, sifjali përcaktore shtesore, skemë e drurit, pasqyrë e pluseve, thënie, tekst, paraprijës, korrelat* (Totoni përdor *fjalë mbështetëse*).

Për termin (periudhë me) *fjali përcaktore*, për të cilin tashmë ka një traditë në shqipe, Koleci parapëlqen termin e huaj, a të huaj e tradicional përzier, të papërshtatshëm *frazë relative*, ose *frazë me fjali të varur relative*, ose *fjali e varur relative*; gjithashtu në vend të termave (*periudhë me sifjali*) *përcaktore plotësore* dhe (*periudhë me sifjali*) *përcaktore shtesore*, që përdor Çeliku në Sintaksën e tij (2012) (ky autor këto dy lloje periudhash përcaktore e termat përkatës të tyre i sheh në kuadrin e klasifikimit të përgjithshëm të periudhave me nënrenditje dhe jo të shkëputura nga ky klasifikim i përgjithshëm, d.m.th. krahas sifjalive të tjera plotësore, siç janë kryefjaloret, kundrinoret, kallëzuesoret), përkundrazi, Koleci në monografinë e saj të botuar më vonë (*Frazat relative të shqipes*, 2013) përdor termat *frazë relative kufizuese* (termi *frazë* përdoret për tjetër gjë në shqipe, dhe për sintagmë në gjuhësinë angleze-amerikane, termi *relative* përdoret edhe për ndërtime të tjera në gjuhësinë angleze, termi *kufizuese* ka kuptim shumë të gjerë) dhe *frazë me fjali të varur relative shtuese*. Këtu nuk është vendi për të dhënë argumentet në të mirë të këtij apo atij termi, por duam të theksojmë se disa autorë nuk i kushtojnë kujdes termave, duke përdorur pa nevojë terma të huaj, ndonjë gjuhëtar, duke qenë i pavendosur, përdor dy a më shumë terma për të njëjtin koncept. Problemi i njësimi të termave është i vështirë; deri në krijimin e traditës së re kombëtare në fushë të terminologjisë kërkohet kohë. Shqipja i ka të gjitha mundësitë për të përkthyer a përshtatur termat e rinj sintaksorë, ajo zotëron mjetet e nevojshme fjalëformuese dhe një traditë të pasur në këtë fushë. Sigurisht gjendja kaotike në fushë të terminologjisë gjuhësore do të jetë e përkohshme dhe për ta mënjeluar atë sa më shpejt ndihmojnë, në radhë të parë, institucionet shtetërore akademike e universitare, të cilave u bie barra e hartimit të një Fjalori terminologjik gjuhësor.

Arritjet e reja teorike e termat e rinj sigurisht reflektohen edhe në tekstet e gjuhës të ciklit 9-vjeçar e të shkollës së mesme. Por aktualisht në këto

hallka të arsimit konceptet e reja e termat e rinj nga fusha e sintaksës deri tani janë futur shumë pak dhe atje mbizotëron këndvështrimi teorik tradicional.

Përditësimi i termave gjuhësorë është një problem i përgjithshëm, pra, jo vetëm i termave të sintaksës. Njësimi terminologjik kërkon konsensus në bazë të disa parimeve të përgjithshme, siç janë, ndër të tjera: mbështetje në traditën terminologjike shqiptare; mbështetje kryesisht në atë gjuhësi të huaj që i ka vënë bazat modernizimit të sintaksës siç është gjuhësia angleze-amerikane; mbështetje në argumente të mjaftueshme për çdo term të veçantë. Siç u tha, hartimi i një fjalori të ri terminologjik është një nga veprat më urgjente që duhet të ndërmerret. Njësimi terminologjik arrihet së pari në arsimin e lartë, pavarësisht mospërputhjeve në rrafshin teorik, mospërputhje që normalisht do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Pas kësaj i vjen radha përfshirjes së koncepteve të reja teorike e termave të rinj në tekstet e gjuhës në shkollat parauniversitare dhe zotërimit të tyre nga pedagogët, mësuesit e gjuhës shqipe e të gjuhëve të huaja. Njësimi e përvetësimi i termave të rinj, jo vetëm të shkencave gjuhësore, por edhe të shkencave të tjera, realizohet kryesisht nëpërmjet shkollës. Për ta ilustruar këtë po sjellim si shembull termat *grup i fjalëve*, *grup emëror*, *grup foljor*, që përdoren gjerësisht në shkollat tona nëntëvjeçare për arsye se u përfshin në tekstet e reja, hartuar nga Beci, Hysa etj., të cilët u mbështetën në terminologjinë franceze.

Për të kontribuar sado pak në stabilizimin e termave të sintaksës në gjuhën shqipe, përveç atyre që dhamë më lart, po radhisim disa nga termat kryesorë sintaksorë, terma të rinj a me kuptim të ri, që i shoh si të përshtatshëm:

fjali-a (angl. sentence), *fjali e thjeshtë* (angl. sentence, clause), *fjali e thjeshtë dykryepërbërëse*, *fjali e thjeshtë njëkryepërbërëse* (angl. one-member sentence), *fjali e thjeshtë njëkryepërbërëse foljore*, *fjali e thjeshtë njëkryepërbërëse emërore*, *fjali e thjeshtë e paplotë*, *fjali e përbërë e paplotë*, *fjali e thjeshtë pa përbërës*, *fjali e përbërë a periudhë* (angl. complex sentence, compound sentence), *sifjali-a* (angl. clause), *sifjali kryesore*, *sifjali drejtuese*, *sifjali kokë*, *sifjali e varur*, *lidhjet sintaksore nënrenditëse* (në fjali të thjeshtë dhe në fjali të përbërë), *lidhjet sintaksore bashkërenditëse* (në fjali të thjeshtë dhe në fjali të përbërë), *fjali të përbëra (periudha) nënrenditëse* (angl. complex sentences), *periudha nënrenditëse me sifjali plotësore* (angl. complement clause) (*kryefjalore plotësore*, *kundrinore plotësore*, *kallëzuesore plotësore*, *përcaktore plotësore*), *periudhë nënrenditëse me sifjali përcaktore-lidhore shtesore* (angl. relative clause), *periudhë nënrenditëse me sifjali të varur rrethanore shtesore (ndajfoljore)* (angl. adverbial clause), *fjalitë e përbëra (periudhat) bashkërenditëse* (angl. compound sentences), *periudhat bashkërenditëse lidhëzore* (me sifjali të lidhura me lidhëza), *periudha bashkërenditëse jolidhëzore* (me sifjali të lidhura pa lidhëza), *periudha*

bashkënditëse jolidhëzore e lidhëzore (me sifjali të lidhura pa lidhëza dhe me lidhëza), *përbërës sintaksor, përbërës sintaksor i thjeshtë, përbërës sintaksor i zbërthyeshem* (angl. kompleks phrase), *përbërës emëror* (*mbiemëror, foljor, ndajfoljor, përemëror, numëror*), *përbërës sifjali, kryepërbërës, bashkëlidhje e ndërsjelltë e kryepërbërësve në fjali, përbërës homogjenë a përbërës sintaksorë të bashkënditur në fjali të thjeshtë e në periudhë, përbarës i veçuar, kokë e përbërësit sintaksor, caktuesor-i* (angl. modifier, specific), *caktuesor i kokës* (*caktuesor i trajtës së emrit, i kalimtarësisë së foljes etj.*), *plotësor-i* (angl. complement, obligatory modifier), *shtesor-i* (angl. adjuncts, optional modifier), *shoqërues* (*modifikues*), *shoqërues i detyrueshem, shoqërues jo i detyrueshem, rrethanor plotësor* (angl. Adverbial Complements, kompleks transitiv complement), *rrethanor shtesor* (angl. adverbial modifier), *sifjali plotësore, sifjali shtesore, krahasor-i, krahasor plotësor, lidhjet gramatikore nënrenditëse të përbërësve sintaksorë* (në fjali të thjeshtë e në periudhë), *mënyrat e lidhjeve gramatikore të varësisë në fjalinë e thjeshtë* (*lidhja me përshtatje, me drejtim, me bashkim*), *lidhjet gramatikore bashkënditëse të përbërësve sintaksorë* (në fjali të thjeshtë e në periudhë), *lidhjet kuptimore të përbërësve sintaksorë* (në fjali të thjeshtë dhe në periudhë), *valencë, thënie-ja* (angl. utterance), *thënie e thjeshtë, thënie komplekse, rend i pjesëve të thënies* (*rend neutral dhe rend emfatik / afektiv*), *predikativitet, kallëzuesi-a, tekst-i, strukturë sintaksore, strukturë e fjalisë, strukturë semantike, strukturë hierarkike, strukturë argumentore, tog-u, pasqyrë e pluseve a pasqyra e lidhjeve të përbërësve, simbol i përbërësit, lidhje përbërësish*; nga fusha e morfologjisë dhe e sintaksës janë me interes edhe termat: *fjalë emërtuese, fjalë gramatikore a fjalëformë-a, fjali këpujore, fjali pësore, fjali pësore e shkurtër, subjekt gramatikor, subjekt logjik, gerund-i, gerund i rasës kallëzore, gerund i rasës rrjedhore, e tashmja e caktuar dhe e pakryera e caktuar, e tashmja e gjendjes dhe e pakryera e gjendjes, e ardhmja e sigurisë, përcjellore pohore dhe përcjellore mohore, përcjellore bashkënditëse, mbaresë shquese, mbaresë e përparme* (e mbiemrave, e gjinorës së emrit) etj.

Informacion i hollësishëm teorik për termat e mësipërm, për nocionet përkatëse, si dhe ilustrime me shembuj gjenden në librin tonë *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbarësit sintaksorë)* (2012). Këta terma në shumicën dërrmuese të rasteve përdoren gjerësisht në gjuhësinë angleze-amerikane dhe në gjuhësitë e vendeve të tjera. Ata janë përshtatur prej nesh në shqipe në bazë të kriterëve të sipërpërmendura, por koha do të tregojë se sa ia kemi arritur. Përdorimi i këtyre termave shpresojmë të ndihmojë sado pak në plotësimin e njësimin e termave sintaksorë. Këta terma do të mënjanojnë nga përdorimi si të panevojshëm: (a) disa terma tradicionalë të papërshtatshëm a të vjetëruar, (b) disa terma të huaj dhe (c) disa terma të rinj që përdoren në ditët tona dhe që

qarkullojnë andej këndeje. Terma të tillë të papërshtatshëm a të panevojshëm (a, b, c) janë p.sh.: *fjali e thjeshtë e pavarur, fjali e mëvetësishme, fjali kryesore, fjali e varur, fjali të bashkërenditura, fjali të nënrenditura, sintagmë, grup fjalësh, frazë* (për fjali të thjeshtë, të përbërë a sifjali), *frazë* (për sintagmë); *nyjë shquese, nyjë e përparme, mbiemër i nyjshëm, togfjalësh; frazë relative, determinant, specifikues, adjunkt, komplement, klitik, aktant, cirkostant, plotës, plotës në kallëzore, plotës ndajfoljor, plotësues, modifikon, specifikon, lokativ direktiv* (për rrethanor plotësor), *relator klasifikativ* (për kallëzuesor), *agjentiv* (për veprues), *afektiv* (për pësues, f. 105) (për përdorimin e katër termave të fundit shih E. Sadiku, “Fjalori i valencave...”, 2014.)

Në fushë të terminologjisë duhet të merret parasysh tradita jonë: kështu termat *periudhë, fjali e përbërë* kanë pasur dhe kanë një përdorim më të gjerë sesa *frazë-a*; madje termi *frazë* përdoret me kuptim tjetër në shqipe, ndërsa në gjuhësinë angleze-amerikane përdoret për *sintagmë*, prandaj termi *frazë* për *fjali e përbërë dhe periudhë* a për *sifjali* krijon pështjellime në gjuhësinë tonë. Termat *sintagmë, grup fjalësh, frazë* mund të zëvendësohen fare mirë me termin *përbërës sintaksor (përbërës i fjalisë, shkurt përbërës)*; simbolet e përbërësve në shqip do të ishin më të përshtatshëm (P, PE, PF, PZ, PSi etj.) sesa simbolet në gjuhë të huaj; ndonjë autor nuk është konseguent në këtë çështje se përdor termin *sintagmë*, por si simbol të tij parapëlqen *P (NP, VP, PP d.m.th. frazë emërore etj.)* (Koleci, 2013).

Si përfundim, sintaksologët e pedagogët e sintaksës, duhet të njësojnë konceptet teorike dhe me mirëkuptim të përdorin terma të njëjtë, gjithashtu edhe hartuesit e programeve dhe të teksteve t’i njohin këto koncepte e termat përkatës e t’i përfshijnë në tekste e reja; mësuesit, nëpërmjet kualifikimeve sistematike, të përditësohen me arritjet e reja teorike e terminologjike e t’ua përcjellin nxënësve në shkollë.

BIBLIOGRAFI

- F. Koleci, *Frazat relative të shqipes parë në këndvështrimin gjenerativist, monografi*, Tiranë, 2013, 279 faqe.
- F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, ShBLU, Tiranë, 2011, 176 faqe.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, II, A.SH.SH., Tiranë, 1996.
- H. Agani, *Ç’shoh të diskutueshme në çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Rev. “Fjala”, 1 shkurt, 15 shkurt, 15 mars 1975.
- L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2007.
- L. Rugova, *Sintagmat sintaksore të shqipes*, S.N. për Gj.,L. dhe K.Sh., 25/1, Prishtinë, 2006.

- M. Çeliku, *Çështje të terminologjisë gjuhësore shqipe (fusha e sintaksës)*, në “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2014, f. 408-412.
- M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Vështrim i ri teorik, Tiranë, 2012, 439 faqe.
- M. Domi, *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, SF, 1984, 4.
- M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe, I, II (dispencë)*, Botim i FHF, Tiranë, 1975.
- M. Totoni, *Sintaksa e gjuhës shqipe, Frazë e përbërë*, Arbëria, 2012, 559 faqe.
- N. Çomski, *Strukturat sintaksore*, Tiranë, 2011.
- R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2003, botim i dytë 2008.
- R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, botim i parë 2002, botim i tretë 2006.
- R. Memushaj, *Tri koncepte themelore të sintaksës moderne*, SF, 1/2, 2008.
- R. Përnaska, T. Plangarica, *Mbi disa skaje filozofike-logjike-gjuhësore në fushën e sintaksës së shqipes, teorisë së të thënit/pragmatikës dhe gjuhësisë tekstore*, në “Terminologjia në shkencat e ligjërit”, Elbasan, 2014.
- S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, 1968, 1.
- S. Floqi, *Disa tipa semantiko-strukturorë të periudhës me fjali të varur në lidhje korrelative*, SF, 1967/3.
- T. Kelmendi, *Kështjellat e sintaksës (Kohë foljore dhe njësi tekstore)*, Prishtinë, 2006, 251 faqe.
- T. Topalli, *Gramatikë e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë, sprovë monografike*, Shkodër, 2011, 746 faqe.
- Th. Dhima, *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe (përmbledhje artikujsh)*, Tiranë, 2013, 278 faqe.
- Th. Dhima, *Frazë me fjali të nënrenditur përcaktore-ndajshimorë të kohës*, monografi, Tiranë, 2013, 196 faqe.

SUMMARY

NEW CONCEPTS AND TERMS OF ALBANIAN SYNTAX

This article treats not just several details of the life of the Albanian syntactician Spiro Floqi, but also deals with issues of syntactic terminology in Albanian. The discussion here springs from several terms used in “Sintaksë e gjuhës shqipe, Përbërësit sintaksorë” (Tiranë, 2012). The author puts forth the fact that the list of the new terms that correspond to new concepts consists of 80 terms. Such terms are “fjali” for *simple and complex sentence*, “fjali e thjeshtë”, “fjali e përbërë”, “përbërës sintaksorë” for *phrase or syntagm*, simple constituent for *one-word phrases*, “përbërës i zbërthyeshëm” for

complex phrase, “caktuesor” for *specifier*, “plotësor” for *complement*, “shtesor” for *adjunct*, etc. The new terms, according to the author, should be derived based on the tradition of Albanian linguistics, the tradition of anglo-american linguistics, and on persuasive arguments for each and every case.

